

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TE KOSOVES

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë në nenin 17.b të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/24, të datës 1 Tetor, 2001 mbi ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20, mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, dhe nenit 3.3 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25 të datës 5 Tetor, 2001 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullat e kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimit.

Me qëllim të zbatimit të nenit 47 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 28 Mars, 2002 ka miratuar me sa vijon:

Rregulli 21 mbi Aktivitetin që ka të bëj me Sigurime

Neni 1

1. Shtrirja e Rregullit

Ky Rregull aplikohet për të gjitha kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit të licencuar nga BPK-ja

2. Autoriteti Ligjor

Ky rregull implementon Nenin 47, kapitullin VI të rregullave të sigurimit.

3. Definicionet

“Aktivitetet e varura” apo “shërbimet e varura”, nënkuptojn çdo biznes apo shërbim që plotëson apo përkrahë udhëheqjen e e biznesit të sigurimeve.

“Aktiviteti që ka të bëjë me sigurime” i referohet katër (4) aktiviteteve të cilat i përmendëm në nenin 47 të rregullores së sigurimeve, duke përfshirë edhe aktivitetin tjetër të biznesit apo shërbimeve të cilat janë, apo mund të jenë të arsyeshme, të varuara që të

udhëhiqen nga biznesi i sigurimeve të lejuara nga ky rregull apo nga BPK-ja, në pajtim me direktivat e saja të shkruara.

“Zyrtari i Lartë” i referohet zyrtarit më të lartë të një entiteti i angazhuar në udhëheqjen e shërbimeve që kanë të bëjnë me sigurime.

Neni 2

Udhëheqja e Lejuar e Aktiviteteve që kanë të bëjnë me Sigurimet

1. Natyra dhe Lloji i Aktiviteteve të Lejuara

Një kompani e sigurimeve, e cila si pjesë të biznesit të saj apo me formimin e një entiteti të ndarë nën pronësinë e saj të vetme, dhe kontrollin apo së bashku me persona tjerë, mund të jetë subjekt i limitimeve dhe kufizimeve të përshkruara në këtë rregull apo nga direktivat e shkruara të BPK-së, merret me aktivitetet që kanë të bëjnë me sigurime me sa vijon:

- a) Verifikimi i Dëmeve dhe rregullimi i shërbimeve.
- b) Qendrat e riparimit dhe shërbimi i zbutjes së (humbjeve) rrezikut.
- c) Qendrat vlerësuese.
- d) Pajisjet për edukim dhe trajnim të sigurimeve.
- e) Ndonjë biznes tjetër të sigurimeve.
- f) Trusti, gjendja administrative, ruajtja apo pranueshmëria.
- g) Biznesi si agjenci siguroese, broker, apo diler i sigurimeve.
- h) Investimet e diskutueshme.
- i) Portofoli i menaxhmentit.
- j) Procesimi i të dhënave.
- k) Dhënja e kredi kartave dhe operimi i sistemit të kredisë të lidhura mbi këtë.
- l) Aktivitete të tjera që kanë të bëjnë me sigurime, dhe që mund të autorizohen nga BPK-ja.

Neni 3

Kërkesat dhe Limitimet në Udhëheqjen e Aktivitetit që ka të bëj me Sigurime

1. Kërkesat e Përgjithshme

- a) Aktivitetet që kanë të bëjnë me sigurime nën paragrafin a), b), c) dhe d) të alines 1, neni 2 I këtij rregulli, mund të udhëhiqet si pjesë e operacioneve të kompanisë së sigurimeve dhe strukturës vetëm nëse aktivitetet janë udhëhequr vetëm si të varura në biznesin e sigurimeve të kompanisë.
- b) Udhëheqja e aktiviteteve që kanë të bëjnë sigurime, për nga natyra dhe Lloji, nga ato të cilave ju referuam në paragrafin a), më lartë, duhet të udhëhiqen nga një kompani e sigurimeve nga një entitet i ndarë i biznesit apo përmes anëtarësimit të saj apo vartësisë.
- c) Nëse natyra e aktiviteti që ka të bëj me sigurime kërkon licensim nga BPK-ja dhe biznesi udhëhiqet edhe më tej, nga entiteti i cili është i ndarë nga kompania e sigurimeve, zyrtari i lartë dhe të gjithë individët që udhëheqin biznesin që ka të bëj me sigurime, duhet të jetë i licensuar me kohë nga BPK-ja
- d) Vetëm me miratim paraprak të shkruar nga BPK-ja, investimet e mjeteve Nga kompania e sigurimeve në çfarëdo biznesi që ka të bëj me sigurime, është subjekt i limitimeve mbi investimet e lejuara (të dyja në lidhje me entitetin e vetëm apo në total të të gjithë këtyre entiteteve), në pajtim me paragrafin q), alinea 1 neni 4, rregulli 12, pjesa II.
- e) Aktiviteti që ka të bëj me sigurime i udhëhequr nën paragrafin e) të Alines 1, nenit 2 të kësaj rregulle (ndonjë biznes tjetër i sigurimeve), duhet të jetë konform kërkesave të licensimit të përshkruara nga Rregullorja e Sigurimeve dhe këtyre rregullave.

2. Limitimet Specifike

Kjo pjesë aplikohet për të gjitha kompanitë e sigurimit që udhëheqin aktivitetete që kanë të bëjnë me sigurime, nëpërmjet një entiteti të ndarë apo më shumë entiteteve:

- a) Përveq se me miratim paraprak të BPK-së, pronësia e drejtë e një kompanie të sigurimit në çfarëdo biznesi të lidhur me sigurime, duhet të jetë konform limitimeve të specifikuara në investimet në vërtesi të kompanisë, në pajtim me paragrafin (i), alinea 2, neni 4 I rregullit 12, pjesa II.
- b) Me miratim paraprak nga BPK-ja, një kompani e sigurimeve mund të investoj

Deri në shumën totale e cila nuk tejkalon pesmbëdhjetë (15%) përqind të mjeteve të saj, me siguri që investimet në cdonjërin entitet, (pamarrparasysh a është entiteti anëtar apo vartës), nuk është më e madhe se pesë (5%) përqind e mjeteve të tilla.

- c) Subjekt i limitimeve të përshkruara në paragrafin b), më lartë, BPK-ja mund ta Miratoj një kompani të sigurimit, të ketë më shumë se dhjetë (10%) përqind, të drejtës së votës së aksioneve në një entitet që ka të bëjë me sigurime, anëtarësi apo vartësi, vetëm nëse kërkesat e mëposhtme përmbushen:
1. Biznesi që ka të bëjë me sigurime është i arsyeshëm, apo i varur nga biznesi i kompanisë së sigurimit.
 2. Kompania e sigurimit i dorëzon një plan biznesi pesë-5 vjeçar të ndarë nga plani i biznesit të entitetit që ka të bëjë biznesin e sigurimit.
 3. Entiteti që ka të bëjë me biznesin e sigurimit pajtohet për të dhuruar fuqi shtesë rregullative BPK-së dhe të dorëzoj pa kushte vetën në pajtim me të gjitha rregullat dhe direktivat të lëshuara nga BPK-ja .
 4. BPK-ja është e bindur se investimet e bëra apo që do të bëhen, dhe involvimi, i kompanisë së sigurimit në entitetin që ka të bëjë me biznesin e sigurimeve janë të dëmshme për interesat e polisambajtësve të kompanisë së sigurimeve.

Neni 4

Kufizimet dhe Udhëheqja e Aktiviteteve që nuk kanë të bëjnë me Sigurime

1. Aktivitetet e Ndaluar

Neni 46 i rregullores së sigurimeve i ndalon kompanitë e sigurimeve (dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve) nga:

1. Angazhimi në ndonjë biznes tjetër nga sigurimet, dhe biznes që ka të bëjë me sigurime, pa autorizim paraprak të BPK-së.
2. Të investoj apo të zotëroj më tepër se dhjetë (10%) përqind të aksioneve me të Drejtë vote, në çfarëdo biznesi që nuk ka të bëjë me sigurime, pa miratim paraprak të BPK-së. kjo ndales vlen edhe për mbajtësit e interesave të rëndësishme, dhe të drejtorëve, zyrtarëve dhe punëtorve të një kompanie të sigurimit (apo të një ndërmjetësuesi të sigurimeve), në mënyrë individuale apo kolektive në mes tyre apo në kombinim me kompaninë e sigurimeve (apo ndërmjetësuesve të sigurimit)

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky rregull, do të hyj në fuqi me 1 Prill, 2002

David Weatherman
Ushtues i Detyrës së Drejtorit Gjeneral